



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

### Njoftim Paraprak Përqendrimi

#### Rasti: Përfitim Kontrolli: ALB-ERK SHPK/VALTELINA SHPK

Në datën 18.01.2018, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar me anë të “Kontratë Shitje Kuotash” (me kusht rishitje). Me anë të kësaj marrëveshje, të nënshkruar me datë 24 Tetor 2017, është realizuar përfitimi i kontrollit të shoqërisë Valtelina SHPK (“Target”) nga shoqëria Alb-Erk SHPK (“Blerësi”).

Ky njoftim plotëson kriteret e xhirove në tregun e brendshëm sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”).

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- Shoqëria Alb-Erk SHPK, me NUIS K91816002D është themeluar më datë 15/06/2009, me adresë: Tiranë Rruga Ndre Mjeda, Nr.42, pranë ish Parkut "21 Dhjetori", e cila ka objekt aktiviteti: import-eksport, tregti me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshëm ushqimore, kryesisht kafe,etj.
- Shoqëria **Pala shitëse 4 (katër) ortakët e shoqërisë:**

Zj. Vjollca Hoxha, Zj Lorela Hoxha, Zj, Sara Hoxha dhe Zj. Redia Hoxha zotëruese të 80% të kapitalit të shoqërisë më ndarje respektive të barabartë prej 20% të kuotave me vlerë të kapitalit prej 60 milion lekë.

Shoqëria Valtelina SHPK, me NUIS J61923012V, është themeluar më datë 26/10/1993, me adresë: Tirane Kashar Mezez Autostrada Tiranë - Durrës, Km. 4,ZK. Nr. 2679, Pasuria 28/21, e cila ka objekt aktiviteti: përpunim, paketim kafeje, import-eksport, tregtia me shumicë dhe pakicë e mallrave, sipërmarrja dhe shërbimi në fusha të ndryshme, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**